



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LIGJI Nr. 03/L-198**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-9 PËR  
UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 02/L-9  
PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE**

**Neni 1**

Në tërë tekstin e ligjit në fuqi shkurtesa **AKM** (Agjencia Kosovare për Mirëbesim) zëvendësohet me shkurtesën **AKP** (Agjencia Kosovare për Privatizim).

Shprehja “**Kompani**” në tërë tekstin e ligjit në fuqi fshihet dhe zëvendësohet me “**Ndërmarrje**”.

**Neni 2**

Neni 1 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Me këtë ligj rregullohet krijimi i infrastrukturës ligjore për ujitje dhe kullimin e tokave bujqësore si dhe funksionimin e subjekteve tjera që ofrojnë shërbime për ujitjen e tokave bujqësore në Republikën e Kosovës dhe mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta.

### **Neni 3**

Neni 2 i ligjit në fuqi fshihet teksti i fjalisë **“formimin dhe regjistrimin e kompanive të ujitjes”** dhe fjalia **“afarizmin e shoqatave”** ndërsa pjesa tjetër e tekstit mbetet e njëjtë.

### **Neni 4**

Neni 3 i ligjit në fuqi Përkufizimet, fshihet **“Zyra Rregullative”** dhe zëvendësohet **“Sektori i Ujitjes dhe Kullimit”** teksti tjetër mbetet i njëjtë.

### **Neni 5**

Neni 4 paragrafi 4.2 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

4.2. Ndërmarrja e ujitjes bënë menaxhimin e ujitës sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 6**

Neni 5 paragrafi 5.1 i ligjit në fuqi ndryshohet si vijon:

Pika d) pas fjalës “kanaleve” shtohet fjala “primare” dhe fshihet fjala “përkatëse” zëvendësohet me “përcjellëse” si dhe fshihet fjala “kufijve” zëvendësohet me fjalën “territorit”.

Pas pikës (e) shtohen dy pika të reja (f) dhe (g) si vijon:

(f) përfaqëson interesat e bujqësisë në sferën e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore në njësitë monitoruese të ndërmarrjeve publike.

(g) i përcakton përgjegjësitë e kufijve fizik në mes të ndërmarrjeve të furnizuara të ujit dhe Shoqatave përdoruese të ujit si dhe në mes të shoqatave.

Paragrafi 5.2 fshihet fjala **“Seksioni”** dhe zëvendësohet me fjalën **“Sektori”**.

Paragrafi 5.2 pika d) riformulohet si vijon :

d) në përbërjen e bordeve mbikëqyrëse të ndërmarrjeve të ujitjes duhet të jetë një anëtarë nga ministria e bujqësisë.

**Paragrafët 5.3 dhe 5.4 të ligjit në fuqi fshihen.**

## Neni 7

Pas nenit 5 të ligjit në fuqi shtohet neni i ri 5A si vijon:

### **Neni 5A Përgjegjësia e komunave:**

Komunat kanë kompetenca për dhënien e udhëzimeve dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të shoqatave në territorin e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## Neni 8

Neni 6 pas paragrafit 6.5 i ligjit në fuqi shtohet paragraf i ri 6.6 me tekstin si vijon:

6.6. Mënyra, forma, përmbajtja dhe procedurat e dhënies së licencës rregullohen me akt nënligjor nga Ministria.

## Neni 9

Kapitulli IV i ligjit në fuqi titulli i këtij kapitulli rritullohet si vijon:

### **BARTJA E PËRGJEGJËSIVE PËR MIRËMBAJTJEN DHE OPERIMIN E SISTEMIT TË UJITJES**

Paragrafi 7.2 fjalia afati “**5 vite**” ndryshohet në “**3 deri 5 vite**”.

## Neni 10

Neni 8 paragrafi 8.1 i ligjit në fuqi në fund të fjalisë “**mbikëqyrëse**”, shtohet teksti si vijon: “**i ndërmarrjes përkatëse**”.

## Neni 11

Neni 9 paragrafi 9.1 i ligjit në fuqi fshihet fjalia “**dispozitat e këtij ligji**” dhe zëvendësohet me fjalinë “**legjislacionin në fuqi**”

Paragrafi 9.2 pas fjalisë pëlqimi fjalia “**i 51%**” ndryshohet në fjalinë “**mbi 50%**”.

Paragrafi 9.3 pas fjalisë ose “**në shfrytëzim toke**” i shtohet fjalia “**bujqësore**”.

## Neni 12

Neni 10 paragrafi 10.1 i ligjit në fuqi teksti pas fjalisë “**sipas planit**” fshihet në tërësi nga teksti i ligjit.

## Neni 13

Neni 11 paragrafi 11.2 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

11.2. Mënyra, procedurat e themelimit dhe regjistrimit të shoqatave rregullohen me akt nënligjor nga Ministria.

## Neni 14

Neni 12 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

Të drejtat dhe përgjegjësitë e shoqatës si dhe anëtarëve të sajë përcaktohen me Statutin e Shoqatës dhe legjislacionin në fuqi.

## Neni 15

Neni 13 paragrafi 13.1 i ligjit në fuqi fjalia “**afati prej 30 ditësh**” zëvendësohet me fjalinë “**afatit kohor të paraparë**” si dhe fjala “**depoziton**” zëvendësohet me fjalën “**dërgon**”.

Paragrafi 13.2 i ligjit në fuqi teksti i fjalisë “**regjistrohet edhe pranë zyrës rregullative të Ministrisë**” zëvendësohet me fjalinë “**evidentohet në Listën përkatëse të Ministrisë**”.

Paragrafi 13.3 i ligjit në fuqi teksti pas fjalisë “**dërgimit në Ministri**” zëvendësohet me fjalinë “**njoftohet Ministria**”.

## Neni 16

Neni 14 pika b) i ligjit në fuqi fjalia “**anëtarëve dhe jo anëtarëve**” zëvendësohet me fjalinë “**shfrytëzuesve**” ndërsa pjesa e tjetër e tekstit mbetet e njëjtë.

Neni 14 pika d) pas fjalës “**kulturave**” shtohet fjala “**bujqësore**”.

## Neni 17

Neni 16 paragrafi 16.2 i ligjit në fuqi fjala “**alineja**” zëvendësohet me fjalën “**paragrafi**” dhe fshihet fjalia “**me Udhëzim Administrativ dhe**”, ndërsa teksti tjetër mbetet i njëjtë.

## **Neni 18**

Kapitulli VII titulli i nenit 17 i ligjit në fuqi riformulohet si vijon:

### **Neni 17 Tarifa e anëtarësimit në shoqata**

Neni 17 paragrafi 17.1 pika a) fshihet.

Neni 17 paragrafi 17.2 fshihet nga teksti i ligjit tërë.

## **Neni 19**

Kapitulli VIII i ligjit në fuqi, titulli i kapitullit fshihet.

## **Neni 20**

Neni 20 paragrafi 20.1 pas fjalisë **“tokën”** shtohet fjalia **“bujqësore”**.

## **Neni 21**

Neni 23 i ligjit në fuqi titulli i nenit fjala **“Krijimi”** zëvendësohet me fjalën **“Themelimi”**.

Neni 23 paragrafi 23.1 fjala **“krijuar”** zëvendësohet me fjalën **“themelohet”**.

## **Neni 22**

Neni 25 paragrafi 25.2 i ligjit në fuqi fjala **“gjithashtu”** fshihet, teksti tjetër mbetet i njëjtë.

## **Neni 23**

Neni 27 paragrafi 27.1 i ligjit në fuqi fjala **“pëlqimi”** zëvendësohet me fjalën **“dhënies”**.

Neni 27 paragrafi 27.2 fjala **“e depoziton”** zëvendësohet me fjalën **“dërgon”** dhe fshihet afatin **“prej 30 ditësh”**, zëvendësohet **“në afatin kohor të paraparë”**, sipas Ligjit Nr.03/L-134 për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare”.

#### **Neni 24**

Neni 29 i ligjit në fuqi fshihet teksti “do të” dhe fjalia “udhëzim administrativ” ndërsa teksti tjetër mbetet i njëjtë.

#### **Neni 25**

Kapitulli X i ligjit në fuqi fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 30 fjala “**Ministria**” zëvendësohet me fjalën “**organet mbikëqyrëse**”.

#### **Neni 26**

Neni 33 paragrafi 33.1 pika c) i ligjit në fuqi fjalia “**anëtarëve dhe jo anëtarëve**” zëvendësohet me fjalën “**shfrytëzuesve**” dhe pika e) fshihet i tërë teksti.

#### **Neni 27**

Neni 34 paragrafi 34.1 i ligjit në fuqi fjalia “**është autorizuar që të bëjë**” zëvendësohet me fjalën “**bënë**”.

#### **Neni 28**

Neni 35 paragrafi 35.3 i ligjit në fuqi fjalia “**i mësipërm**” zëvendësohet me **fjalinë “këtij neni”** si dhe pas fjalës “**tokës**” shtohet fjala “**bujqësore**”.

#### **Neni 29**

Kapitulli XIV i ligjit në fuqi titulli i kapitulli dhe neni 37 riformulohet si vijon

#### **Neni 37**

##### **Mbikëqyrja inspektuese**

Zbatimi i këtij ndryshim plotësimi të ligjit për ujitjen e tokave bujqësore bëhet nga inspektorët e tokave bujqësore në bashkëpunim me inspektorët relevant.

### **Neni 30**

Neni 38 i ligjit në fuqi ndahet në dy paragraf dhe riformulohet si vijon:

38.1. Të hyrat e krijuara nga zbatimi i këtij ligji derdhën në Buxhetin e Kosovës.

38.2. Të drejtat dhe përgjegjësitë të inspektorëve të tokave bujqësore përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

### **Neni 31**

Për zbatimin e këtij ligji, Ministria obligohet në afat prej dymbëdhjetë (12) muajve të nxjerr akte nënligjore.

### **Neni 32**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-198**  
**8 korrik 2010**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**